

REPUBLIKA E KOSOVËS DEPARTAMENTI I MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPESINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	No. i Prot. 7463 Baza Prot. 7463 Prot. No. Shtet. 02.11.22 Detyrimi Emri
01 01 PRISHTINË / A No. 2	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit , Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7 datë 01 mars 2019, Prishtinë), Shtojcën 1.10 të Rregullores nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 21 të Ligjit për transportin rrugor Nr.04/L-179, nenit 7 të Udhëzimit Nr.09/2013 për rjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndërurban të udhëtarëve me autobus, nxjerr:

VENDIM

1. Të bëhet shpallja publike e nisjeve të lira të subvencionuara në transportin ndërurban, përfshirë afatin e aplikimit , mënyrën e aplikimit dhe tërheqjen e dokumentacionit për aplikim.
2. Të afishohet në Web-faqen e MMPHI-së dhe në tabelë pranë zyrave të DTT-së: Relacioni me oraret e lira për aplikim, kriteret për aplikim dhe kushtet e përgjithshme të shpalljes publike.
3. Detyrohet Departamenti i Transportit Tokësor në zbatimin e këtij vendimi.

Shtojcë e këtij vendimi janë:

Lista me nisje të shpallura nëpër regjione, kriteret për aplikim dhe kushtet e përgjithshme të shpalljes publike.


Servet Spahiu

Sekretar i Përgjithshëm z.v




Iu dërgohet:

Kabinetit të Ministrit;
 Sekretarit të Përgjithshëm;
 Departamentit të Transportit;
 Arkivit të MMPHI-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

DATË/A:	01.11.2022
REFERENC-Ë:	031/449
PËR/ZA/TO:	z. Servet Spahiu- zv. Sekretar i Përgjithshëm
CC:	z. Hysen Durmishi - zv. Ministër i MMPHI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Xhemë Veseli , Drejtor i DTT-së 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim/Propozim për subvencionimin e linjave ekonomiksht të paqëndrueshme

I nderuar Sekretar,

Bazuar në nenin 4 , paragrafi 2 , nenpragrafi 2.7; neni 17, paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-179 për transportin rrugor; U.A. Nr.26/2017 dhe U.A 01/2022 për plotesimin dhe ndryshimin e U.A Nr.26/2017 për subvencionimin e linjave ekonomiksht të paqëndrueshme në transportin ndër-urban të udhëtarëve me autobus; Udhezimin Administrativ 09/2013 dhe plotesim ndryshimin e U.A 06/2016 , për rrjetin e linjave dhe rendet e udhëtimet në transportin ndër-urban të udhëtarëve me autobus , MMPHI me vendimin e dt; 10.10.2022 dhe nr.protokoli 6831 ka bërë shpalljen publike për nisjet e lira në transportin ndër-urban , andaj deri në afatin e kërkuar për dorëzimin e kërkesave për nisje të lira , DTT konstaton se nuk kemi aplikacione për nisje të lira , dhe konform procedurave ligjore kërkon iniciimin e procedurave për subvencionimin e linjave ekonomiksht të paqëndrueshme në relacionet në të cilat nuk mbahet asnjë nisje e rregullt sipas rrjetit të linjave ndër-urbane të aprovuar nga Ministria, si në vijim;

REGJIONI I PRISHTINËS

Relacioni: Prishtinë - Keqikolle - Mutivodë

Nisja	Kthimi
07:30	10:30
11:30	13:30
15:00	18:30

REGJIONI I MITROVICËS

Relacioni: Bistrice e Shales -Koshtove- Ceraj- Mitrovicë

Nisja	Kthimi
07:30	17:00

Relacioni: Qabër-Mitrovicë

Nisja	Kthimi
07:30	12:30
13:30	18:30

Relacioni: Vidimiriq - Mitrovicë

Nisja	Kthimi
06:15	06:45
13:30	18:30

Relacioni: Kodra e Minatorve- Mitrovicë

Nisja	Kthimi
07:00	07:30
10:00	10:30
13:00	13:30
17:00	17:30

REGJIONI I GJILANIT

Relacioni: Llabjan-Novobërdë

Nisja	Kthimi
07:30	08:00
13:30	14:00
15:00	16:00

⚡ Përmbajtja e shpalljes publike.

Shpallja publike për paraqitjen e aplikacioneve për subvencionimin e linjave ekonomiksht të paqëndrueshme në relacionet si vijon ;

- 1) Relacioni : Prishtinë – Keqikolle - Mutivodë dhe anasjelltas;
- 2) Relacioni : Bistrice e Shales –Koshtove- Ceraj- Mitrovicë dhe anasjelltas
- 3) Relacioni : Qabër – Mitrovicë dhe anasjelltas
- 4) Relacioni : Vidimiriq – Mitrovicë dhe anasjelltas
- 5) Relacioni : Kodra e Minatorëve – Mitrovicë dhe anasjelltas
- 6) Relacioni : Llabjan-Novobërd dhe anasjelltas

⚡ Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorëve;

1. Aplikacionin dhe fletpagesen ;
2. Licencë për transport “C” ose “D” të lëshuar nga MMPHI –ja për të cilën nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit (Kopje);
3. Dëshmitë mbi Kompetencën Profesionale për menaxher te operatorit transportues (CPC- e noterizuar);
4. Menaxheri i operatorit te Transportit rrugor nuk mund te paraqitet edhe si shofer per vertetim dhe vazhdim te rendit te udhetimit;
5. Dëshminë për numrin e shoferëve të punësuar:
 - i. 5.1.-për relacionin deri në 50 km së paku një(1) shofer për tre(3) 3 rende të udhëtimit;
 - ii. 5.2.-për relacionin mbi 50 km së paku një(1) shofer për dy(2) rende të udhëtimit;
6. Dëshminë për kapacitetet përkatëse të autobusëve të destinimit ndër-urban të regjistruar dhe të siguruar ne Kosovë dhe të certifikuar nga MMPHI-ja sipas licencës “C” apo “D” (librezat e qarkullimit, polisa e sigurimit dhe kartoni gjashtëmujor(nese aplikohet) te noterizuara,
 - ❖ Kapacitetet teknike të prezantuara në lëndën përkatëse do të kalkuloohen në raport me numrin e nisjeve në transportin ndër-urban dhe atë ndërkombëtar në evidencat e DTT-së;
7. Vërtetimin (jo më të vjetër se 30 ditë) e organeve kompetente për kontributet e të punësuarve/vërtetimi tatimor për të punësuarit sipas pikës (4 dhe 5); kontratat e punës (origjinal apo të noterizuara); patentë shoferi (kopje),
8. Tri kopje të rendit të udhëtimit për të cilin aplikon sipas formës dhe përmbajtjes së aprovuar nga Ministria(origjinal).
9. Dëshminë se menagjeri dhe shoferët e operatorit aplikues janë në marrdhënje të rregullt pune, Kontratat e punës(origjinal apo të noterizuara), Pasqyra e kontributeve pensionale apo vertetimi i ATK-së.
10. Me rastin e aplikimit për vërtetimin e rendit të ri të udhëtimit operatori do te paguaj tarifën prej;
 - Ne relacionin deri ne 30 km 10 € per çdo nisje;
 - Ne relacionin deri ne 50 km 20 € per çdo nisje, dhe
 - Ne relacionin mbi 50 km 30 € per çdo nisje
11. Dëshmitë për nisjet nëse posedon në transportin ndërurban (kopjet e rendeve të udhëtimit të vërtetuara nga MMPHI-ja) dhe transportin ndërkombëtar(kopjet e lejeve për operim në transportin ndërkombëtar të vërtetuara nga MMPHI-ja), MMPHI-ja mbanë të drejtën e verifikimit të të gjitha nisjeve ndërurbane dhe lejeve të transportit ndërkombëtar që posedojnë operatorët duke u mbështetur në evidencat e DTT-së(kopje).
12. Pagesat do te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve në llogarinë bankare të ofruesit te sherbimeve (operatorit te transportit).

13. Pagesa mujore ,pas pranimit te raportit te sherbimeve-kilometrave te realizuara dhe te pranuar nga menaxheri i projektit/personi pergjegjes i MMPHI-së/Departamentit te Transportit , te shoqeruara me tahografet.
14. Tahografet kopje duhet te jene te vertetuar nga origjinali nga ana e Menaxherit te Operatorit Ekonomikë .
15. Raporti i realizimit te sherbimeve duhet te jet identik me kohen e nisjes ; kilometrat e kaluara dhe te regjistruara ne tahograf.
16. Ne tahograf nuk guxon te intervenohet dhe te ket korigjime .
17. Tahografet jo ne rregull do te refuzohen nga pagesa dhe pranimi i sherbimeve .
18. Per tahografet jo ne rregull pergjegjes eshte Operatori ekonomikë ;
19. Rendi i udhetimit për subvencionimin e linjave ekonomikisht te paqendrueshme, vertetohet per periudhen 3 vjeqare me mundesi vazhdimi;
20. Subvencionimi i linjave bëhet për kilometrat e kaluara nga operatori përfitues,. Çmimi për kilometër për subvencionim është; 50 % e vlerës së derivatit (që djeg automjeti/autobusi) brenda muajit në të cilin faturohet .
21. Operatori në transportin në linjat ekonomikisht të pa qëndrueshme është i obliguar që të ju lëshoi biletën secilit udhëtar me pagesë.
22. Çdo dymbëdhjetë (12) muaj do të bëhet vlerësimi i nevojave për subvencionim nga Ministria në koordinim me komunën përkatëse – parashtruese e kërkesës.
23. Personat me nevoja të veçanta, pensionistët dhe fëmijët deri në moshën 12 vjeçare janë të liruar nga bileta,të dokumentuar me dëshmi

✚ Mënyra e Aplikimit:

1. Aplikacioni i plotësuar se bashku me dokumentacion duhet të dorëzohet në Arkivin e MMPHI-së Ish ndërtesa e Gërmisë nga data:

➤ 01.11.2022 deri me datën: 15.11.2022 në ora 12.00

2. Dokumentacioni dorëzohet në një origjinal dhe një kopje ne dy zarfe te veçanta. Zarfet janë te mbyllur dhe shënuar “te mos hapet”.
3. Komisioni do të zgjedh aplikacionin i cili i ka plotësuar më së miri kriteret e përcaktuara ne shpalljen publike;
4. Hapja e aplikacioneve behet ne lokalet e MMPHI-së

(Departamenti i Transportit Tokësor me datën:15.11.2022 në orën:13.30;

5. Informatat më të hollësishme merren në zyrën Nr.C109. Ish ndërtesa e Gërmisë.
Tel. 038 211 511,038 213 394.

I tërë dokumentacioni duhet të jetë i vulosur dhe nënshkruar nga menaxheri i operatorit aplikues si dhe i numëruar për çdo fletë te dokumentacionit. Aplikacioni i pa kompletuar ,pa nënshkruar dhe pa vulosur nga menaxheri i operatorit transportues nuk do të shqyrtohet fare dhe do të konsiderohet i anuluar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Transportit Rrugor/Sektor drumskog saobraćaja/Road Transport Department

A p l i k a c i o n Nr: _____

Për për subvencionimin e linjave ekonomikisht të paqëndrueshme “

Relacioni: _____

Operatori : _____

Licenca nr. _____ Komuna _____

e-mail: _____

Tel-fax: _____

Fletëpagesën për çdo nisje në vlerë prej;

- Ne relacionin deri ne 30 km 10 € per çdo nisje;
- Ne relacionin deri ne 50 km 20 € per çdo nisje, dhe
- Ne relacionin mbi 50 km 30 € per çdo nisje

Relacioni: _____ dhe anasjelltas

Nisja: / ¹_____ / / ²_____ / / ³_____ /

Kthimi: /_____/ /_____/ /_____/

Emri dhe mbiemri i menaxherit,

data e aplikimit

Vula dhe nënshkrimi

Vërejtje:

Për te dhëna jo te sakta përgjigjet menaxheri i Operatorit Transportues.

Me respekt